



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1049/2 prot.,

Datë 30.04.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “SHEHU” SHPK në procedurën e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar - Shërbime*”, *prokurim elektronik – Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 12 mua*” me nr. **REF-00079-04-04-2024**, me objekt: “*Shërbim transporti materialesh sipas marrëveshjes me Fondin Shqiptar të Zhvillimit në Bashkinë Mat*”, me fond limit: **1 640 000** (një milion e gjashtëqind e dyzet mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 15.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mat.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “SHEHU” SHPK me NIPT J66702707S dhe adresë Ndërtesa 1-katëshe, me zonë kadastrale nr. 2592 dhe me nr. Pasurie 440, në rrugën nacionale Pesh, Dibër.

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Mat me adresë Sheshi “Kastriotët”, Nr.1, KP 8001, Burrel.

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2024/4035, datë 29.04.2024 dhe me Nr.1049/2024 Prot., datë 30.04.2024 e operatorit ekonomik “SHEHU” SHPK, për procedurën e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar - Shërbime*”, *prokurim elektronik – Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 12 mua*” me nr. **REF-00079-04-04-2024**, me objekt: “*Shërbim transporti materialesh sipas*

*marrëveshjes me Fondin Shqiptar të Zhvillimit në Bashkinë Mat*”, me fond limit: **1 640 000** (një milion e gjashtëqind e dyzet mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 15.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mat.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “SHEHU” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “SHEHU” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

*“Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “SHEHU” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:*

*I. Nuk janë përmbushur përcaktimet e pikës 1 gërma “a” dhe “b”/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:*

*1. Ofertuesi duhet të paraqesë:*

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*- Këto kushte nuk përmbushen nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur konstatohet se:*

*- Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit nuk është paraqitur sipas formatit të miratuar të shtojcës 9 në DST për shërbime.*

*- Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit nuk është nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor/ administratori i shoqërisë, por nga ortaku i vetëm i shoqërisë.*

*- Gjithashtu, në seksionin “Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit - A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRZGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT” të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, nuk është deklaruar emri i përfaqësuesit ligjor/ administratorit të shoqërisë se nuk është i dënuar/ ose ka qënë i dënuar për veprat penale të përcaktuara në nenin 76 të LPP-së.*

- Formulari i Sigurimit të Ofertës me Nr.serial:240601366, datë 15.04.2024, nuk është lëshuar për procedurën objekt prokurimi me Nr. REF-00079-04-04-2024, por për procedurën e mëparshme të anuluar me Nr. REF-94635-02-06-2024.

Për këto arsye në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik1” (i ndryshuar), neni 80, 82, 92 pika 3 të tij, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) neni 26, 40, 82 të tij,

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) unanimisht vendosi të s’kualifikojë Operatorin Ekonomik, shoqëria “SHEHU” Sh.p.k., pasi nuk përmbush të gjitha kushtet dhe kërkesat e paraqitura në njoftimin e kontratës.”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 30.04.2024.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**

**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**

**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**

**Fiorent Zguro**